

VENDIM
Nr. 73, datë 10.5.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “PROPOZIMIT TË TË GJITHA OST-ve TË EVROPËS KONTINENTALE PËR KARAKTERISTIKAT SHITESË TË FRC-së NË PËRPUTHJE ME NENIN 154 (2) TË RREGULLORES SË KOMISIONIT TË BE-së 2017/1485, TË DATËS 2 GUSHT 2017, QË PËRCAKTON NJË UDHËZUES PËR OPERIMIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 7, nenit 19, si dhe nenit 67, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 154 (2) të Rregullores së Komisionit të BE-së 2017/1485, të datës 2 gusht 2017, që përcakton një “Udhëzues për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”; në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 167, të Kodit të Transmetimit, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017; nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe duke konsideruar se, Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a., është anëtar me të drejta të plota i ENTSO-E, bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 10.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, për fillimin e procedurës për miratimin e “Propozimit të të gjitha OST-ve të Evropës Kontinentale për karakteristikat shtesë të FRC-së, në përputhje me nenin 154 (2) të Rregullores së Komisionit të BE-së 2017/1485, të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- OST sh.a., me shkresën nr. 2060 prot., datë 15.3.2019, ka përcjellë në ERE për miratim “Propozimin e të gjitha OST-ve të Evropës Kontinentale për karakteristikat shtesë të FRC-së në përputhje me nenin 154 (2) të Rregullores së Komisionit të BE-së 2017/1485, të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”.

- Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të nenit 7 dhe nenit 19, si dhe nenit 67, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, përkatësisht neni 167 “Sigurimi i FCR-së”.

- “Rezervat e mbajtjes së frekuencës” ose “FCR” nënkupton rezervat e fuqisë aktive të disponueshme për të mbajtur frekuencën e sistemit pas shfaqjes së një çekuilibrimi.

- Ky dokument është një propozim i përbashkët i krijuar nga të gjithë operatorët e sistemeve të transmetimit në lidhje me zhvillimin e karakteristikave shtesë të rezervave për mbajtjen e frekuencës, neni 154 i Rregullores së Komisionit të BE-së 2017/1485, të datës 2 gusht 2017.

Ky dokument vjen si propozim i përbashkët i zhvilluar nga të gjithë operatorët e sistemit të transmetimit të zonës sinkron të Evropës Kontinentale në lidhje me zhvillimin e karakteristikave shtesë të rezervave për mbajtjen e frekuencës, neni 154 (2) i Rregullores së Komisionit të BE-së 2017/1485, të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e propozimit të të gjitha OST-ve të Evropës Kontinentale për karakteristikat shtesë të FCR-së, në përputhje me nenin 154 (2) të Rregullores së Komisionit të BE-së 2017/1485, të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht) ka përparësi në rast mosdakordësie nga palët në interpretim të versionit shqip.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti